



Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04-0049553-2 dt. 21.08.2026
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenet 37 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative, Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, bashkëpunimit me Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës dhe Kërkesës nr. 01-020/02-0049553/26, të datës 20.08.2026 nga Drejtoria e Administratës, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

(Për Formimin e Komisionit për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Praktikantëve në Punë në bashkëpunim me Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës)

1. **Formohet** Komisioni për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Punëkërkesëve në bashkëpunim me Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës në programin Praktikë në Punë, në këtë përbërje:
 - 1.1 Hanife Rushiti – kryesuese (DA);
 - 1.2 Skofiar Sylja – anëtar (DA);
 - 1.3 Edona Konusheci – anëtare (DA).
2. Komisioni është përgjegjës që të bëjë vlerësimin e të gjithë dokumentacionit dhe përzgjedhjen e punëkërkesëve nga lista e gjerë e propozuar nga Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës, sipas kritereve të përcaktuara për angazhimin e praktikantëve në Komunën e Mitrovicës së Jugut;
3. Komisioni obligohet që në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, dhe konform dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative, Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, akteve tjera ligjore relevante dhe kritereve të përcaktuara, të bëjë vlerësimin dhe përzgjedhjen e punëkërkesëve të cilët do të realizojnë praktiken në punë në Komunë e Mitrovicës së Jugut.
4. Gjatë fazës së vlerësimit Komisioni obligohet që të mbaj Procesverbal nga momenti i hapjes së procesit e deri në marrjen e Vendimit, duke përfshirë edhe pikëzimin me rastin e vlerësimit.
5. Pas përfundimit të vlerësimit Komisioni sjell procesverbal mbi përzgjedhjen e praktikantëve dhe parashtron rekomandim me listën e punëkërkesëve të përzgjedhur për praktik në punë.

6. Komisioni i formuar sipas pikës një (1) të këtij Vendimi ka mandat deri në përfundimin e fazës së vlerësimit dhe përzgjedhjes.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës

Faton PEÇI

Shtojcë:

- 1x1 Email zyrtar i datës 18.08.2026 nga z. Fadil Osmani – Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës;
- 1x1 Email zyrtar i datës 18.08.2026 nga z. Alban Fejzullahu – Drejtoria për Administratë e KKM;
- 1x1 Email Zyrtar i datës 19.08.2026 nga znj. Arta Azemi – Kabineti i Kryetarit të Komunës.

Ti dërgohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Drejtorisë për Administratë
- 1x1 Anëtarëve të Komisionit
- 1x1 Arkivit